

Nr. Prot. 039/B/18

VENDIM Nr. 1226

Për

Ndryshimin dhe Plotësimin e

“Rregullores për Kontratat, transparencën dhe publikimin e informatave dhe masave tjera mbrojtëse për përdoruesit fundorë për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”

Në mbështetje të nenit 1, nenit 10, paragrafi 4), nenet 64, 65, 66, neni 79, paragrafi 1) dhe 2) dhe neni 85 i Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*) dhe në përputhje me dispozitat e nenit 10 paragrafi 2.1), nenit 11 paragrafi 3.3) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar i Bordit
- 2) z. Nijazi Ademaj Anëtar i Bordit
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar i Bordit
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar i Bordit

në mbledhjen e 29-të me radhë të mbajtur më datë 22 Qershor 2018, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE) dhe Departamenti Ligjor (DL), unanimisht mori këtë:

V E N D I M

I. Ndryshohet neni 11 paragrafi 5) si në vijim:

- “Më qëllim të zbatimit të paragrafit 11.4)...”

II. Ndryshohet neni 19.2 i **“Rregullores Nr.38 për Kontratat, transparencën dhe publikimin e informatave dhe masave tjera mbrojtëse për përdoruesit fundorë për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”** (*Ref. Nr.Prot.022/B/18*), si në vijim:

- “Përveç paragrafëve 11.5 deri 11.7, kjo Rregullore hynë në fuqi (dyzetë e pesë) 45 ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.”

III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: *“Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”*

Neni 85 paragrafi 7.1.2.2 i Ligjit përcakton që kontratat së paku duhet të përmbajë: *“informacionin për kushtet tjera që kufizojnë qasjen dhe/ose përdorimin e aplikacioneve dhe shërbimeve, aty ku këto kushtëzime janë të lejuara në bazë të legjislacionit në fuqi”,* poashtu paragrafi 7.1.2.3 i këtij neni përcakton që kontrata duhet të përmbajë: *“niveli më i ulët i kualitetit të shërbimit të ofruar, d.m.th. koha për inicimin e thirrjes dhe, ku është e përshtatshme, parametrat tjerë të kualitetit të shërbimeve të definuara nga Autoriteti.”*

ARKEP me vendimin nr.1176 (Ref. Nr.Prot.021/B/18) ka miratuar **“Rregulloren nr.38 për Kontratat, transparencën dhe publikimin e informatave dhe masave tjera mbrojtëse për përdoruesit fundorë për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.**

Në nenin 11 paragrafi 5 i Rregullores nr. 38 është përdorur referenca në nenin 10 paragrafi 4 në vend të nenit 11 paragrafi 4.

Poashtu, në neni 19 paragrafi 2) të Rregullores janë përdorur referencat në nenin 10.5 deri 10.7 në vend të 11.5 deri 11.7.

Tutje neni 19, paragrafi 2) i Rregullores nr. 38 ka specifikuar si në vijim: *..., kjo Rregullore hynë në fuqi gjashtëdhjetë (60) ditë pas miratimit nga Bordi i Autoritetit.*

Më datë 13 Qershor 2018, operatorët Telekom i Kosovës sh.a. dhe IPKO Telecommunications LLC (Ref. e-mail: Wed, June 13, 2018 11:15 AM dhe Wed, June 13, 2018 1:23 PM) kanë parashtruar kërkesë në ARKEP lidhur me shtyrjen e afatit për hyrjen në fuqi të Rregullores për së paku 30 ditë.

Sipas operatorëve, kërkesa për shtyrje vjen për arsye të intenzitetit të shtuar të punës gjatë kësaj periudhe dhe konsultimeve të hapura publike si, analizës së tregjeve, hapjes së brezeve, pastaj, përpilimi i raportit të FDC-së, implementimi i kodit, etj. Andaj, duke marr në konsideratë rëndësinë dhe implikimet finale, të cilat dalin në raport me konsumatorët, operatorët konsiderojnë se është i nevojshëm një afat shtesë deri në përfundimin e ndryshimit të kontratave në përputhje me kërkesat sipas rregullorës së re.

Duke pas parasyshë atë që u tha më lartë si dhe me qëllim të implementimit të Kornizës Rregullatore të BE-së lidhur me net neutralitetin, respektivisht Rregullores Nr.2015/2120 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 25 Nëntor 2015 për përcaktimin e masave lidhur me qasjen në internetin e hapur, atëherë është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit.

Prishtinë, 04/07/2018

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informativë;
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike, ARKEP;
- Departamentit Ligjor, ARKEP
- Arkivit, ARKEP